



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 148 Akti

Nr. 163 Vendimi
Tiranë, më 19.06.2019

V E N D I M

Trupit gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Firdes Shuli	Anëtare
Etleđa Çiftja	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, në datën 17 qershor 2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Esmeralda Keshi (Cami), prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleđa Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), vëzhguesin ndërkombëtar, z. John Leonardo, dhe pasi shqyrtoi në

tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Esmeralda Keshi (Cami) është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe në ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, znj. Esmeralda Keshi (Cami), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.5.2018, me trupin gjykues të përbërë nga:

Pamela Qirko	Komisionere
Firdes Shuli	Komisionere
Etleđa Çiftja	Komisionere

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim si “DSIK”) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim si “IKLD”) sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim si “Komisioni”), me vendimin nr. 1, datë 25.5.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 6.6.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5, të nenit D dhe të neneve DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

6. Në datën 6.6.2019, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda datës 13.6.2019;

(iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda pesë ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*;

(iv) si dhe përbërjen e trupit gjykues.

7. Në datën 13.6.2019, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Përmes postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 17.6.2019, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, Tiranë.

8. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Në datën 17.6.2019, u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 edhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo. Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë personalisht.

10. Seanca dëgjimore e datës 17.6.2019 u ndërpre, për të rifilluar, në datën 19.6.2019, për shpalljen e vendimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Subjekti i rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror;
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; dhe
- iii. Prokuroria e Përgjithshme është organi përkatës i vlerësimit profesional i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

13. Referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. ILDKPKI-ja, me shkresën nr. ***, datë 11.5.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2008, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

15. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2008 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar në datën 25.1.2017, “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI nga viti 2004 deri në 2016; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit në datën 13.6.2019, me nr. *** prot., e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

17. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në

¹ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

V/3 Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

1. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

1.1 Deklaratën “Vetting” të viti 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur².

1.2 Dokumentacionin e administruar nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

1.3 Dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”.³

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

1.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon një llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”. Gjendja e llogarisë në datën 23.01.2017 është 1,600,144.06 lekë. Pjesa takuese: 50%.

1.5 Si burim krijimi, subjekti ka deklaruar: (1) pagë prokurori pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër, orë jashtë orarit; (2) raport lindjeje dhe shpërblim për barrë lindje, nga DRSSH-ja Dibër; (3) pagë prokurori pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, orë jashtë orarit; (4) bursë në Shkollën e Magjistraturës.

1.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella nga “Raiffeisen Bank”, në emër të Esmeralda Keshi konfirmohet gjendje llogarie në datën 23.1.2017, në vlerën 1,600,144.06 lekë.

1.7 Sipas vërtetimeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se të ardhurat janë në vlerën 6,892,641 lekë, për periudhën 2011 (kohë kur fillon shtimi i llogarisë) deri në dhjetor 2016 (periudha e fundit para deklarimit).

1.8 Në përgjigje të pyetjes se kur subjekti i rivlerësimit ka bashkëjetuar me personin e lidhur para martesë ajo deklaroi se jetesa e përbashkët ka filluar në dhjetor të vitit 2013, ndërkohë që lidhja ligjore e martesës është kryer në datën 10.10.2014.

² Vërtetim nr. *** prot., datë 21.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës, shuma 981.375 lekë; vërtetim datë 18.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shuma 803,523 lekë; vërtetim page nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shuma 7,616,161 lekë; vërtetim page nga DRSSH Dibër, shuma 290,667 lekë; nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank”, në emër të Esmeralda Cami (Keshi), gjendja e llogarisë në vlerën 1,600,144 lekë.

³ Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2018.

1.9 Sipas vërtetimeve të pagës së bashkëshortit, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit⁴ dhe të marra nga Komisioni⁵, konstatohet se të ardhurat janë në shumën 2,416,451 lekë për periudhën 2014 deri në dhjetor 2016 (periudha e fundit para deklarimit).

1.10 Për të vërtetuar burimin e krijimit u krye analiza financiare në të cilën u mor në konsideratë koha nga fillimi i krijimit të gjendjes fillestare në mënyrë akumulative deri në datën 31.12.2016. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortit, duke qenë se në dhjetor 2013 subjekti i rivlerësimit ka bashkëjetuar dhe ka pasur të ardhura, sipas tabelës së mëposhtme:

Përshkrim	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shtesa / pakësime likuiditetesh						
Shtesa / pakësime të llogarive bankare ⁶	150,237	215,517	- 56,524	499,954	853,131	897,013
Shtesa / pakësime të gjendjes <i>cash</i>	0	0	0	0	0	0
Total shtesa / pakësime likuiditetesh	150,237	215,517	- 56,524	499,954	853,131	897,013
Detyrime	0	0	0	0	0	0
Total detyrime	0	0	0	0	0	0
Të ardhura						
Të ardhura nga pagat subjekti	882,000	845,017	1,282,257	1,229,291	1,178,680	1,184,729
Të ardhura nga pagesat e Sigurimeve për barrë lindje subjekti	0	0	0	140,482	150,185	0
Të ardhura nga pagat bashkëshortit	0	0	0	737,949	788,394	890,108
Total të ardhura	882,000	845,017	1,282,257	2,107,722	2,117,259	2,074,837
Shpenzime						
Shpenzime jetese sipas anketës së buxhetit të familjes INSTAT ⁷	434,304	434,304	434,304	803,412	674,652	758,544
Shpenzime qiraje	180,000	30,000	63,000	156,000	156,000	156,000
Shpenzime për udhëtime brenda vendit	0	52,500	0	0	80,000	72,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	0	6,986	0	28,022	53,684	27,054
Total shpenzime	614,304	523,790	497,304	987,434	964,336	1,013,598
Balanca e fondeve (të Ardhura-Pasuri+Detyrime-Shpenzime)	117,459	105,710	841,477	620,334	299,793	164,226

⁴ Vërtetim nr. ***, datë 31.10.2016, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë Vendore Korçë, periudha janar 2008 – korrik 2010.

⁵ Vërtetim nr. ***, datë 23.5.2019, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë së Antiterrorit; vërtetim nr. ***, datë 23.5.2019, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.

⁶ Llogari rrjedhëse nr. *** në "Raiffeisen Bank" e subjektit; llogari kursimi nr. *** në "Raiffeisen Bank" e subjektit; llogari rrjedhëse nr. *** në "Raiffeisen Bank" e bashkëshortit të subjektit (periudha 2014-2016).

⁷ Për periudhën 2008–2013, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka banuar në qytete të ndryshme, janë konsideruar shpenzime jetike për një person në rang kombëtar. Për periudhën 2014–2016, janë konsideruar shpenzime jetike sipas Qarkut të Dibrës për një NJEF në rang vendi.

1.11 Komisionit, nga hetimi administrative, bazuar në faktet e sipërpërmendura, i rezultoi se: Lidhur më të ardhurat nga paga të bashkëshortit të subjektit pranë Drejtorisë së Aniterrorit, për periudhën 1.7.2015 – 31.12.2016, ka mospërputhje midis vërtetimit nr. *** prot., datë 5.1.2017, në vlerën 1,337,353 lekë (dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI) dhe vërtetimit nr. ***, datë 23.5.2019, në vlerën 1,278,491 lekë (nga hetimi i Komisionit). Diferenca është në vlerën 58,862 lekë. Subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me këtë konstatim.

1.12 Në përgjigje subjekti i rivlerësimit deklaroi se për të vërtetuar të ardhurat e bashkëshortit të saj ka depozituar vërtetimin nr. ***, datë 5.1.2017, të Drejtorisë së Aniterrorit, për periudhën 1.7.2015 – 31.12.2016. Përveç vërtetimit ka paraqitur edhe “*nxjerrje llogarie*” në “Raiffeisen Bank”, por nga ana e saj, nuk ishte proceduar me krahasimin e të dhënave. Në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Aniterrorit, ka pasaktësi, pasi përpiluesi i tij, duhet të ketë konsideruar si të ardhura, vlera që nga bashkëshorti i saj, janë realizuar në formën e dietës apo kompensimit për veshmbathje, kompensim i cili jepet për punonjësit e policisë me veshje civile.”

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar dokumentacion justifikues për të mbështetur deklaratimet e saj⁸.

1.13 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të deklaruara.

2. Llogari kursimi në “Raiffeisen Bank”

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

2.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëngjitur.⁹

2.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI dhe Komisioni.

2.3 Dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”¹⁰.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

2.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se disponon llogari kursimi në “Raiffeisen Bank”. Gjendja e llogarisë në datën 23.01.2017 është në vlerën 930,106.22 lekë. Pjesa takuese: 50%.

2.5 Si burim krijimi subjekti deklaroi se kanë shërbyer të ardhurat që derivojnë nga llogaria rrjedhëse në masën 30,000 lekë/muaj.

2.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se: Sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella nga “Raiffeisen Bank”, konfirmohet gjendje llogarie në vlerë 930,106.22 lekë, në datën 23.01.2017, në emër të znj. Esmeralda Keshi.

⁸ E-mail i datës 22.5.2019; kërkesë, datë 22.5.2019, drejtuar Drejtorisë së Antiterrorit Sektorit të Financës, Tiranë; nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank”, datë 10.6.2019.

⁹ Vërtetim nr. ***, datë 21.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës, shuma 981,375 lekë; vërtetim, datë 18.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shuma 803,523 lekë; vërtetim page nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shuma 7,616,161 lekë; vërtetim page nga DRSSH-ja Dibër, shuma 290,667 lekë; nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank”, në emër të znj. Esmeralda Cami (Keshi).

¹⁰Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2018.

2.7 Sipas vërtetimeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se të ardhurat janë në shumën 3,883,367 lekë, për periudhën 2014 (kohë kur fillon shtimi i llogarisë) deri në dhjetor 2016 (periudha e fundit para deklarimit).

2.8 Në përgjigje të pyetjes se kur subjekti i rivlerësimit ka bashkëjetuar me personin e lidhur para martesë ajo deklaroi se jetesa e përbashkët ka filluar në dhjetor të vitit 2013, ndërkohë që lidhja ligjore e martesës është kryer në datën 10.10.2014.

2.9 Sipas vërtetimeve të pagës së bashkëshortit, të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit¹¹ dhe të marra nga Komisioni¹² konstatohet se të ardhurat janë në shumën 2,416,451 lekë për periudhën 2014 deri në dhjetor 2016 (periudha e fundit para deklarimit).

2.10 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, përgjatë periudhës së krijimit të këtyre likuiditeteve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur të ardhura, pasuri dhe shpenzime sipas tabelës së mëposhtme:

Përshkrim	2014	2015	2016
Shtesa / pakësime likuiditetesh			
Shtesa / pakësime të llogarive bankare	499,954	853,131	897,013
Shtesa / pakësime të gjendjes <i>cash</i>	0	0	0
Total shtesa / pakësime likuiditetesh	499,954	853,131	897,013
Detyrime	0	0	0
Total detyrime	0	0	0
Të ardhura			
Të ardhura nga pagat subjekti	1,229,291	1,178,680	1,184,729
Të ardhura nga pagesat e sigurimeve për barrë lindje, subjekti	140,482	150,185	0
Të ardhura nga pagat bashkëshorti	737,949	788,394	890,108
Total të ardhura	2,107,722	2,117,259	2,074,837
Shpenzime			
Shpenzime jetese sipas anketës së buxhetit të familjes INSTAT ¹³	803,412	674,652	758,544
Shpenzime qiraje	156,000	156,000	156,000
Shpenzime për udhëtime brenda vendit	0	80,000	72,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	28,022	53,684	27,054
Total shpenzime	987,434	964,336	1,013,598
Balanca e fondeve (Të ardhura – Pasuri + Detyrime - Shpenzime)	620,334	299,793	164,226

¹¹ Vërtetim nr. ***, datë 31.10.2016, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë Vendore Korçë, periudha janar 2008 – korrik 2010.

¹² Vërtetim nr. ***, datë 23.5.2019, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë së Antiterrorit; vërtetim nr. ***, datë 23.5.2019, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.

¹³ Për periudhën 2014–2016, janë konsideruar shpenzime jetike sipas Qarkut të Dibrës për një NJEF në rang vendi.

2.11 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të deklaruara.

3. Llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank” e bashkëshortit të subjektit, z. G.K.

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

3.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.¹⁴

3.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

3.3 Dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”¹⁵.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

3.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaron se bashkëshorti i saj disponon llogari rrjedhëse në “Raiffeisen Bank”. Gjendja e llogarisë në datën 24.01.2017 është në vlerën 706.41 lekë. Subjekti zotëron 50 %. Pjesa takuese: 50 %.

3.5 Si burim krijimi subjekti deklaron se kanë shërbyer të ardhurat nga paga pranë Drejtorisë së Antiterror Tiranë, Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.¹⁶

3.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se sipas lëvizjeve të llogarive bankare të përcjella nga “Raiffeisen Bank”, konfirmohet gjendje llogarie në vlerën 706.41 lekë, në datën 24.1.2017, në emër të z. G.K.

3.7 Në përgjigje të pyetjes se kur subjekti i rivlerësimit ka bashkëjetuar me personin e lidhur para martesë ajo deklaron se jetesa e përbashkët ka filluar në dhjetor të vitit 2013, ndërkohë që lidhja ligjore e martesës është kryer në datën 10.10.2014.

3.8 Sipas vërtetimeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, konstatohet se të ardhurat janë në shumën 3,883,367 lekë, për periudhën 2014 (kohë kur fillon shtimi i llogarisë) deri në dhjetor 2016 (periudha e fundit para deklaramit).¹⁷

3.9 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, përgjatë periudhës së krijimit të këtyre likuiditeteve, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur të ardhura, pasuri dhe shpenzime sipas tabelës në pikën **2.10**.

3.10 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e administruara gjatë hetimit, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për këto të ardhura të deklaruara.

4. Pjesë 1/6 në një apartament me sip. 83 m², në Bulqizë

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

¹⁴ Nxjertje llogarie “Raiffeisen Bank”, në emër të z. G.K., për periudhën 23.11.2005 – 24.1.2017.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2018.

¹⁶ Vërtetim nr. ***, datë 31.10.2016, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë Vendore Korçë; vërtetim nr. ***, datë 23.5.2019, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë së Antiterrorit; vërtetim nr. ***, datë 23.5.2019, të ardhura nga paga pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.

¹⁷ Vërtetim nr. ***, datë 21.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës, shuma 981.375 lekë; vërtetim datë 18.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, shuma 803,523 lekë; vërtetim page nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, shuma 7,616,161 lekë; vërtetim page nga DRSSH-ja Dibër, shuma 290,667 lekë;

4.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.¹⁸

4.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

4.3 Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Bulqizë.¹⁹

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

4.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaron se është trashëgimtare ligjore në 1/6 pjesë e apartamentit me sip. 83 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, Bulqizë.

4.5 Si burim krijimi deklarohet trashëgimia ligjore nga babai N.C., i cili ka vdekur në datën 19.4.2016. Subjekti deklaron se çmimi i përcaktuar nga Udhëzimi Këshillit të Ministrave nr. ***, datë 28.12.2016, për qytetin e Bulqizës është 83 m² x 41,800 lekë/m² = 3,469,400 lekë. Pjesa takuese: 1/12 ose 8.33%.

4.6 Nga hetimi administrativ kryesisht u konstatua se referuar dokumentacionit të administruar nga ILDKPKI-ja, ZQRPP, me shkresën nr. ***, datë 05.10.2017, ka bashkëlidhur shkresën e ZVRPP-së Bulqizë, nr. ***, datë 29.9.2017, e cila konfirmon se znj. Esmeralda Keshi (Cami), ka të regjistruar pasuri me nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, lloji i pasurisë apartament me sip. 83 m², në bashkëpronësi me pjesë 1/3, fituar me trashëgimi, bashkëlidhur dëshmia e trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 25.4.2017 dhe kartela e pasurisë apartament me sip. 83 m², ku vihet re se apartamenti është blerë nga N.C., në vlerën 200,000 lekë, në vitin 2003 dhe ka kaluar në pronësi të L.C., N.C., dhe Esmeralda Keshi.

Nga hetimi i Komisionit, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 19.12.2018, ZVRPP-ja Bulqizë, na informon se pas verifikimeve në regjistrat e pasurive të paluajtshme rezulton se znj. L.C., ka në pronësi apartament me nr. pasurie ***, z.k. ***, Bulqizë, me sip. 83 m².

4.7 Komisionit, nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, i rezultoi se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën “Vetting 2017” dhe dokumentacionit justifikues të dorëzuar në ILDKPKI në lidhje me bashkëpronësinë ligjore mbi këtë aset, pasi: (a) në deklaratën “Vetting” subjekti deklaron bashkëpronësi ligjore në masën 1/6 dhe 1/12 pjesë të këtij apartamenti me sip. 83 m² në Bulqizë; (b) ndërkohë që nga dokumentacioni i ardhur nga ZVRPP-ja Bulqizë në ILDKPKI dhe në Komision subjekti nuk figuron bashkëpronar deri më 21.01.2018.

4.8 Në përgjigjen e pyetësorit nr. 3, protokolluar me nr. ***, datë 29.5.2019, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me origjinën e pronës deklaroi se ky apartament është fituar nga prindërit e saj nëpërmjet kontratës së shitblerjes së vitit 2003. Është aplikuar për çeljen e trashëgimisë dhe është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore me nr. ***, datë 25.4.2017, për trashëgimlënësin N.E.C., dhe trashëgimtarët Esmeralda Keshi (Cami), N.C., dhe

¹⁸ Vërtetim nr. ***, datë 23.1.2017, nga ZVRPP-ja Bulqizë, ku vërtetohet se në z.k. ***, figuron i regjistruar apartament me sip. 83 m², në pronësi të N.C., bashkëlidhur vërtetimit: certifikata e pronësisë datë 4.6.2003, për apartament me sip. 83 m², ndodhur në Bulqizë, certifikatë familjare e përbërë nga 5 pjesëtare, certifikatë vdekje e babait N.C., dhe F.C., (vëllai i subjektit të rivlerësimit), certifikatë familjare e N.C., dhe L.C.

¹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 7.1.2019, bashkëlidhur: inventari i brendshëm i dosjes ref. ***, dhjetor 2017; aplikim nr. ***, datë 18.12.2017; mandatdepozitimi në “Raiffeisen Bank”, datë 18.12.2017; llogaritja e tatimit për kalimi e së drejtës së pronësisë, datë 18.12.2017; akt noterial për heqje dorë nga bashkëpronësia nr. ***, datë 15.12.2017; certifikatë pronësie, datë 2.5.2017, në emër të Esmeralda Keshi, L.C., N.C., me pjesë takuese 1/3 secila; kartela e pasurisë, datë 15.12.2017 dhe harta treguese e regjistrimit, ID përkatëse; kartelë pasurie datë 28.1.2018.

bashkëshorten L.C. Subjekti i rivlerësimit depozitoi dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar deklaratimet e saj²⁰.

4.9 Në Deklaratën e Interesave Privatë të vitit 2017, lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo pasuri, ndonëse e fituar nga prindërit e saj gjatë martesës, është regjistruar vetëm në emër të babait të saj, N.C. Me depozitimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 25.4.2017, lëshuar për trashëgimlënësin N.C., nga ZVRPP-ja Bulqizë, janë bërë ndryshimet përkatëse të pronësisë mbi pasurinë me nr. ***, por pa veçuar më parë pjesën e bashkëshortit në masën 1/2, duke bërë gabimisht bashkëpronarë në 1/3 pjesë të pasurisë secilin prej trashëgimtarëve. Subjekti deklaroi se ajo dhe vëllai i saj duhej të ishin bashkëpronarë në 1/6 pjesë secili, dhe mamaja e saj bashkëpronare me 4/6 pjesë të pasurisë apartament me nr. ***.

4.10 Duke qenë se nuk ishte e qartë se cila është pjesa takuese e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në pyetësorin e datës 22.5.2019, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me faktin se si ka dalë në përllogaritjen e pjesës 1/12 ose 8.33%.

4.11 Në përgjigjen e dërguar, protokolluar me nr. ***, datë 29.5.2019, subjekti deklaroi se pas vdekjes së babait të saj, duke u bërë automatikisht trashëgimtare ligjore në pjesën takuese të kësaj pasurie, e ka deklaruar atë në deklaratën “Vetting”, edhe pse kjo pasuri nuk ishte ende në posedim të saj. Subjekti i rivlerësimit pranoi gjithashtu se në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting” ka interpretuar gabim Kodin e Familjes së Republikës së Shqipërisë dhe, konkretisht, nenin 77 të tij, duke e konsideruar gabimisht pasurinë që rrjedh nga trashëgimia si pasuri e bashkësisë ligjore. Për pasojë, pjesa takuese është pjesëtuar për dy, duke e konsideruar veten dhe bashkëshortin e saj bashkëpronarë në masën 50% të pasurisë që rrjedh nga trashëgimia ligjore e secilit. Për pasojë, pjesa e saj takuese si trashëgimtare ligjore nga pasuria apartament me sip. 83 m² është 1/6 e pasurisë ose ≈ 16.7 %.

4.12 Për pasurinë apartament me sip. 83 m² është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore me nr. ***, datë 25.4.2017, për trashëgimlënësin N.E.C., dhe trashëgimtarët Esmeralda Keshi (Cami), N.C., dhe bashkëshortja L.C. Me certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 2.5.2017, subjekti i rivlerësimit në cilësinë e trashëgimtares ligjore, është bërë pronare në 1/3 pjesë të apartamentit. Në datën 15.12.2017 subjekti dhe vëllai i saj kanë hequr dorë nga bashkëpronësia mbi 1/3 pjesë të apartamentit, në favor të bashkëpronares nënës së subjektit, znj. L.C., me anë të aktit noterial nr. ***, datë 15.12.2017, “Për heqje dorë nga bashkëpronësia mbi pasuri të paluajtshme”. Vërtetuar kjo me kopjen e certifikatës së pronësisë nr. ***, datë 21.1.2018, për pasurinë me nr. ***, me pronare të vetme shtetasen L.C.

4.13 Analiza ligjore e Komisionit

Komisioni në lidhje me këtë pasaktësi në deklaratim vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm arsyet e kësaj mospërputhje dhe për më tepër që në lidhje me këtë pasuri, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore në datë 25.4.2017, periudhë e cila rezultoi 3 muaj pasi subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar në muajin janar në Deklaratën Vetting.

Komisioni gjithashtu vlerëson se interpretimi i gabuar i Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë, në përcaktimin e pjesëve takuese të saj si trashëgimtare ligjore, nuk ka sjellë asnjë pasojë në lidhje me shtimin apo pakësimin e pasurisë së subjektit nga burime të paligjshme.

²⁰ Kontratë shitblerje banese nr. ***, datë 3.6.2003 lidhur ndërmjet shitësve S.S., etj., dhe blerësit N.E.C., për shitblerjen e apartamentit me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, certifikatë për vërtetim pronësie, në emër të N.E.C., lëshuar në datën 4.6.2003; dëshmia e trashëgimisë ligjore me nr. ***, datë 25.4.2017.

Këto pasaktësi, nuk sjellin pasoja në këtë proces, duke qenë se subjekti i rivlerësimit provoi bindshëm me dokumentacion ligjor justifikues si ligjshmërinë e burimit të pasurisë ashtu dhe heqjen dorë nga bashkëpronësia mbi këtë pasuri.

Për sa më sipër, plotësohen kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të cilat parashikojnë se subjekti i rivlerësimit duhet të provojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të pasurisë së saj, e cila gjithashtu arriti në nivel të besueshëm të provojë pasaktësitë e deklaruara.

4.14 Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, çmon se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me pjesën takuese të këtij apartamenti, të fituar me anë të trashëgimisë ligjore. Komisioni çmon se këto pasaktësi e përjashtojnë rrezikun e gjendjes në situatën e parashikuar nga geramat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

5. Pjesë takuese 1/16 në një apartament me sip. 58 m², në Bulqizë

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

5.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.²¹

5.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

5.3 Dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Bulqizë.²²

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

5.4 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se është bashkëpronarë e trashëgimisë ligjore të bashkëshortit në 1/16 pjesë e apartamentit me sip. 58 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, Bulqizë.

5.5 Si burim krijimi deklarohet trashëgimia ligjore nga babai i bashkëshortit, i ndjeri L.K., i cili ka vdekur në datë 6.4.2016. Subjekti deklaroi se çmimi i përcaktuar nga Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. ***, datë 28.12.2016, për qytetin e Bulqizës është 58 m² x 41,800 lekë/m² = 2,424,400 lekë. Pjesa takuese: 1/16 ose 6.25%.

5.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se ZVRPP-ja Bulqizë, në përgjigje të shkresës nr. *** prot., datë 19.12.2018, ka dërguar informacion se nuk konfirmon pasuri në emër të G.K. dhe U.K.

5.7 Nëpërmjet pyetësorit nr. 3, dërguar me *e-mail* në datën 22.5.2019, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë dokumentacionin ligjor justifikues të origjinës për mënyrën e fitimit të pronësisë dhe dëshminë e trashëgimisë lidhur me këtë apartament.

5.8 Në përgjigjen e pyetësorit nr. 3, protokolluar me nr. ***, datë 29.5.2019, subjekti sqaron se pasuria apartament me sipërfaqe 58 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***, Bulqizë, është fituar nga prindërit e bashkëshortit të saj nëpërmjet privatizimit nga Ndërmarrja

²¹Vërtetim nr. ***, datë 23.1.2017, nga ZVRPP-ja Bulqizë, ku vërtetohet se në z.k. ***, figuron e regjistruar pasuri apartament me sip. 58 m², në bashkëpronësi të L.K., dhe U.K., bashkëlidhur shkresës: certifikatë pronësie, datë 5.11.2007, për apartament me sip. 58 m², ndodhur në Bulqizë, në emër të L., dhe U.K., certifikatë familjare e përbërë nga pesë pjesëtarë, datë 18.10.2016, certifikatë vdekjeje e të ndjerit L.K., datë 18.10.2016 dhe certifikatë familjare e z. U.K., datë 20.1.2017.

²²Shkresa nr. *** prot., datë 7.1.2019, bashkëlidhur: inventari i brendshëm i dosjes ref. ***, dhjetor 2017; aplikim nr. ***, datë 18.12.2017; mandatdepozitimi në “Raiffeisen Bank”, datë 18.12.2017; llogaritja e tatimit për kalimi e së drejtës së pronësisë, datë 18.12.2017; akt noterial për heqje dorë nga bashkëpronësia nr. ***, datë 15.12.2017; certifikatë pronësie, datë 2.5.2017, në emër të Esmeralda Keshi, L.C., N.C., me pjesë takuese 1/3 secili; kartela e pasurisë, datë 15.12.2017, dhe harta treguese e regjistrimit, ID përkatëse; kartelë pasurie datë 28.1.2018.

Komunale Banesa Bulqizë në vitin 1993 dhe ka vënë në dispozicion kopje të dokumenteve justifikues ligjorë²³. Subjekti sqaroi se për trashëgimlënësin L.Q.K., nuk është bërë çelja e trashëgimisë ligjore dhe nuk është aplikuar ende për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë.

5.9 Me vërtetim kontrate “*shitblerje banese*” me nr. ***, datë 31.10.2007, dhe kontratës për privatizimin e banesës, datë 17.7.1993, konfirmohet se babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z. L.K., është blerësi i këtij apartamenti nga Shoqëria Anonime Ujesjellës Bulqizë sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, me çmimin e shitjes 3,400 lekë.

5.10 Duke qenë se nuk ishte e qartë se cila është pjesa takuese e pasurisë, në pyetësorin e datës 22.5.2019, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me faktin se si ka dalë në përllogaritjen e pjesës 1/16 ose 6.25%.

5.11 Në përgjigjen e dërguar, protokolluar me nr. ***, datë 29.5.2019, subjekti deklaroi se pas vdekjes së babait të bashkëshortit të saj, duke u bërë automatikisht trashëgimtarë ligjorë në pjesën takuese të kësaj pasurie, e ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, edhe pse kjo pasuri nuk ishte në posedim. Subjekti i rivlerësimit pranoi gjithashtu se në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting” ka interpretuar gabim Kodin e Familjes së Republikës së Shqipërisë. Referuar nenit 77, të Kodit të Familjes, as ajo dhe as bashkëshorti i saj nuk mund të jenë përfitues të pjesës takuese nga trashëgimia ligjore e tjetrit, për pasojë, pjesa takuese e secilit nga trashëgimia është e barabartë me pjesën e fituar me trashëgiminë ligjore dhe asnjëri nuk gëzon të drejta mbi pasuritë e tjetrit, të fituara me trashëgimi, për shkak të regjimit pasuror të bashkësisë ligjore. Në përfundim, subjekti deklaroi se pjesa takuese e bashkëshortit të saj si trashëgimtar ligjor për pasurinë apartament me sip. 58 m², është 1/8 e pasurisë ose 12.5 %.

5.12 Analiza ligjore e Komisionit

Komisioni në lidhje me këtë pasaktësi në deklaram, vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm arsyet e kësaj mospërputhje, si dhe vlerëson se interpretimi i gabuar i Kodit të Familjes së Republikës së Shqipërisë, në përcaktimin e pjesëve takuese të bashkëshortit të saj si trashëgimtar ligjor, nuk ka sjellë asnjë pasojë në lidhje me shtimin apo pakësimin e pasurisë së subjektit nga burime të paligjshme.

Këto pasaktësi, nuk sjellin pasoja në këtë proces, duke qenë se subjekti i rivlerësimit provoi bindshëm me dokumentacion ligjor justifikues ligjshmërinë e burimit të pasurisë.

Për sa më sipër, plotësohen kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të cilat parashikojnë se subjekti i rivlerësimit duhet të provojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të pasurisë, ku gjithashtu u arrit në nivel të besueshëm të provohen pasaktësitë e deklaruara.

5.13 Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, çmon se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e subjektit në lidhje me deklaratimet e pjesës takuese të këtij apartamenti, të fituar me anë të trashëgimisë ligjore. Komisioni çmon se këto pasaktësi e përjashtojnë rrezikun

²³ Kërkesë e datës 31.10.2007, me kërkues L.Q.K.; vërtetim kontrate shitblerje banese nr. ***, datë 31.10.2007, lidhur ndërmjet Shoqërisë Anonime Ujesjellës Bulqizë dhe blerësit L.K.; mandatarkëtimi nr. ***, datë 17.7.1993; kontratë për privatizim banese formulari nr. ***, datë 17.7.1993, e lidhur ndërmjet Ndërmarrjes Komunale Banesa, përfaqësuar nga përgjegjësit e sektorit të privatizimit, A.Ç., dhe qytetarit L.K., për privatizimin e banesës nr. ***, lagja “***”, apartamenti nr. ***, shkalla nr. ***, kati ***, i përbërë nga një dhomë dhe një kuzhinë; formulari nr. ***, me treguesit kryesorë të apartamentit dhe planimetria e apartamentit etj.; certifikatë për vërtetim pronësie, në emër të z. L.Q.K., dhe znj. U.R.K., lëshuar në datën 5.11.2007.

e gjendjes në situatën e parashikuar nga germat “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

6. Automjetet në përdorim, autoveturë e markës “Mercedez Benz”, me targë ***

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi:

6.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur.²⁴

6.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

6.3 Deklarimet e dhëna Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve dhe dokumentacionit justifikues.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

6.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 subjekti i rivlerësimit deklaroi një automjet në përdorim, të markës “Mercedez Benz”, me targë ***, me numër shasie ***, me vit prodhimi 2000, në pronësi të shtetasit N.C.

6.5 Komisioni konstatoi se subjekti **nuk ka deklaruar burim krijimi** në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

6.6 Në pyetësin nr. 2, datë 14.5.2019, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti nga personi tjetër i lidhur, shtetasi N.C.

6.7 Në përgjigje të pyetësit, protokolluar me nr. ***, datë 21.5.2019, subjekti sqaroi se i vëllai, shtetasi N.C., ka punuar si punonjës policie pranë Komisarariatit të Policisë Dibër për periudhën dhjetor 2010 – shtator 2013. Nga shtatori i vitit 2013 dhe deri më sot ka punuar si punonjës policie pranë Komisarariatit të Policisë së Kufirit Dibër. Gjithashtu, babai i saj, shtetasi N.E.C., prej vitit 2006 ka qenë punonjës i OSHEE-së Bulqizë. Në përfundim subjekti sqaroi se si burim për blerjen e automjetit të markës “Mercedez Benz” me targa ***, kanë shërbyer kursimet ndër vite nga paga e vëllait, z. N.C., dhe babait të saj, z. N.C. Për të provuar deklaratat e tij, subjekti i vlerësimit ka dorëzuar dokumentacion ligjor provues²⁵.

6.8 Në përgjigje të pyetësit nr. 3, protokolluar me nr. ***, datë 29.5.2019, subjekti ka paraqitur kopjen e kontratës së shitblerjes së automjetit nr. ***, të datës 15.10.2015.

6.9 Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor²⁶ na informon lidhur me dokumentacionin e fitimit të pronësisë që ndodhen në dosjet e regjistrimit të automjeteve me targa:

- *** (blerë në datën 3.2.2018) dhe *** (i cili figuron në statusin *çregjistrim i përhershëm*), regjistruar në pronësi të shtetasit G.K.;
- ***, regjistruar në pronësi të shtetasit N.C.;

²⁴ Autorizim nr. ***, datë 16.10.2015, ku rezultoi se N.C., pronar i mjetit të markës “Mercedez Benz”, me targë ***, autorizon z. G.K., të qarkullojë me këtë mjet brenda dhe jashtë vendit, bashkëlidhur autorizimit: kartë ID, certifikatë pronësie dhe leje qarkullimi të automjetit me targë ***, në emër të z. N.C.

²⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 15.5.2019, lënda “vërtetim”, lëshuar nga Komisarati i Policisë Kufitare Dibër; vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër; nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, në emër të N.N.C. për periudhën 13.10.2009 – 31.12.2015; nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, në emër të N.E.C., për periudhën 1.1.2010 – 31.12.2015; shkresa nr. *** prot., datë 16.5.2019, lënda “vërtetim page”, lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 22.5.2019.

- Për automjetin me targë *** nuk paraqiten të dhëna nga DPSHTRR-ja, pasi referuar kontrolleve në AMF rezultoi që mjete t'i jetë shitur z. L.C.

6.10 Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, Komisioni kreu analizën financiare për mundësitë e personit tjetër të lidhur/N.C., për të blerë automjetin me targë ***.

Periudha 1.1.2014 - 30.9.2015	Vlera
Të ardhura nga paga, N.C., dhe N.C.,	1,944,158
Shpenzime jetike sipas anketës së buxhetit të familjes INSTAT ²⁷	- 1,309,401
Blerë, automjet me targa ***	- 280,080
Diferenca e mbetur	354,677

6.11 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit dhe ato të administruara gjatë hetimit, çmon se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe ka burime financiare me dokumentacion justifikues ligjor për të ardhura që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti.

7. Apartament me qira në lagjen “*”, Peshkopi, në pronësi të shtetasit Sh.A., kundrejt qirasë mujore 13,000 lekë/muaj.**

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi

7.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur

7.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

7.3 Deklarimet e dhëna Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve dhe dokumentacionit justifikues.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

7.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka një apartament me qira në lagjen “***”, Peshkopi, në pronësi të shtetasit Sh.A., Paga e qirasë mujore prej 13,000 lekë/muaj.

7.5 Me qëllim për të provuar marrëdhënien e qirasë, subjekti ka paraqitur në deklaratën “Vetting” deklaratën e datës 20.1.2017, nga shtetësja Xh.T., nëna e bashkëshortes së shtetasit Sh.A., e cila administron pagesat e qirasë.

7.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se marrëdhënia e qirasë nuk është formalizuar me akt noterial.

7.7 Për të vërtetuar lidhjen midis pronarit dhe administtores subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacioni justifikues ligjor për marrjen me qira të apartamentit si dhe lidhjen midis qiradhënëses dhe administtores znj. Xh.T.

7.8 Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, protokolluar me nr. ***, datë 21.5.2019, subjekti i rivlerësimit për sa më sipër shpjegoi se pas transferimit të bashkëshortit të saj, G.K., në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, kanë jetuar në një apartament me qira, me adresë: lagja “***”, p. ***, ap. ***, shk. ***, Peshkopi. Banesa i është marrë me qira shtetasit Xh.T., administtores e apartamentit (pronarët e banesës shtetasit Sh.A., dhe E.A.(T.), jetojnë në Greqi). Paga e qirasë mujore prej 13,000 (trembëdhjetë mijë) lekë në muaj, është mbuluar

²⁷ Shpenzime jetike sipas anketës së buxhetit të familjes për qarkun Dibër, për tre persona (N.C., N.C., L.C.).

nga të ardhurat e siguruara nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe paga e bashkëshortit të saj, i është bërë çdo muaj shtetases Xh.T. Subjekti deklaroi se nuk disponon kontratë qiraje dhe për të provuar deklaratimet e saj, depozitoi deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.5.2019 të shtetases Xh.T., dhe dokumentet²⁸ që provojnë pronësinë mbi pasurinë apartament dhe lidhjen e shtetases Xh.T., me shtetasen E.A.

7.9 Komisioni, në pyetëtorin nr. 3, dërguar me *e-mail* në datën 22.5.2019, i kërkoi subjektit të shpjegojë arsyet se përse nuk ka nënshkruar një kontratë qiraje, duke qenë se kishte kaluar një periudhë më shumë se 1 vit me qira tek i njëjti apartament, referuar nenit 803, të Kodit Civil të, Republikës së Shqipërisë, në të cilin citohet: “*Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë së një vit, duhet bërë me shkresë*”.

7.10 Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, protokolluar me nr. ***, datë 29.5.2019, subjekti sqaroi se pronarët e apartamentit të marrë me qira prej shumë vitesh jetojnë në Greqi. Në kohën kur apartamenti është marrë me qira ata nuk ndodheshin në Shqipëri dhe apartamenti i ishte lënë për përkujdesje shtetases Xh.T., nënës së E.A., me të cilën kishin rënë dakord se kontrata e qirasë do të lidhej me pronarët e banesës, por rastet kur ata të dy bashkë kanë ardhur në Shqipëri kanë qenë shumë të rralla dhe nuk ishte bërë e mundur të realizohej lidhja e kontratës.

7.11 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë pasur të ardhura, pasuri dhe shpenzime sipas tabelës në *pikën 2.10*. dhe kanë të ardhura të mjaftueshme për të paguar detyrimin e qirasë mujore prej 13,000 lekë.

7.12 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, shpjegimet e dhëna dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, dhe duke i interpretuar në harmoni me njëra-tjetrën, çmon se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë përdorimin e këtij apartamenti, si dhe shpjegoi bindshëm se përse nuk kishte një akt të shkruar midis saj dhe pronarëve të apartamentit.

8. Tokë arë, me sip. 368 m², me nr. pasurie *, vol. ***, f. ***, në z.k. ***, Tiranë**

a. Komisioni për vërtetimin e faktit administroi:

8.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe dokumentacionin bashkëlidhur²⁹.

8.2 Provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja dhe Komisioni.

8.3 Deklarimet e dhëna Komisionit me anë të përgjigjeve të pyetjeve dhe dokumentacionit justifikues me anë të postës elektronike.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm

8.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se ka pasuri para martese, tokë arë, me sip. 368 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në z.k. ***, Tiranë. Kjo

²⁸ Deklarata noteriale nr. ***, datë 15.5.2019 e shtetases Xh.T.; karta e identitetit e znj. Xh.T.; aktnoterial për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme (apartament); certifikatë familjare e znj. Xh.T., datë 15.5.2019, Bashkia Dibër; certifikatë personale e znj. Xh.T., Bashkia Dibër; certifikatë personale e z. Sh.A., Bashkia Dibër; certifikatë personale e znj. E.A., Bashkia Dibër.

²⁹ Certifikatë pronësie nr. ***, datë 14.1.2011, në emër të G.K., për pasurinë tokë arë me sip. 368 m², ndodhur në Kamëz, Tiranë; kartelë pasurie për arën me sip. 368 m², në vlerën 103.776 lekë; hartë treguese e pasurisë; kontratë shitblerjeje toke bujqësore nr. ***, datë 27.12.2010, me blerës G.K., për tokë arë me sip. 368 m², me çmim 282 lekë/m², në total 103.776 lekë; certifikatë pronësie nr. ***, datë 20.7.2010 për arën me sip. 368 m², në pronësi të z. H.H., kartelë pasurie, hartë treguese vërtetim nr. ***, datë 3.12.2010 nga Bashkia Kamëz; certifikata familjare; prokura të posaçme.

tokë është blerë në bazë të kontratës nr. ***, datë 27.12.2010 nga shtetasi H.H. Vlera: 103,776 lekë. Pjesa takuese: 100%.

8.5 Burim për krijimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar pagën e bashkëshortit pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.

8.6 Nga hetimi administrativ kryesisht, në pyetësonin nr. 2, datë 14.5.2019, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të shpjegojë qëllimin e blerjes së kësaj prone në Kamëz dhe nëse bashkëshorti i saj e ka zhvilluar këtë pronë (ka ndërtuar, e ka dhënë me qira etj.)

8.7 Në përgjigje të pyetësonit, protokolluar me nr. ***, datë 21.5.2019, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se pasuria tokë arë, me sipërfaqe 368 m², ishte blerë nga bashkëshorti i saj, z. G.K., me qëllim zhvillimin e pronës në të ardhmen, deri më sot kjo pasuri nuk është zhvilluar asnjëherë dhe as nuk janë bërë përpjekje për zhvillimin e saj. Nuk është dhënë në asnjë rast me qira, si dhe nuk janë realizuar të ardhura në asnjë moment nga posedimi i kësaj pasurie.

8.8 Me shkresën nr. ***, datë 27.5.2019, Drejtoria Vendore Kamëz – Vorë, vërtetoi se nuk rezultojnë pasuri në emër apo në pronësi të znj. Esmeralda Keshi dhe znj. U.K. Bashkëlidhur kësaj shkrese është vënë në dispozicion kopja e kartelës dhe referencës nr. ***, datë 14.1.2011, me të cilën është regjistruar pasuria nr. ***, në pronësi të z. G.K.³⁰

8.9 Komisioni kreu hetim të mëtejshëm për çmimin e pasurisë, bazuar për koordinatat e sakta të vendndodhjes³¹ së kësaj prone.

8.10 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në shkresën nr. *** prot., datë 22.5.2019 na informoi se shtetësja Esmeralda Keshi dhe personat e lidhur me të, nuk figurojnë si subjekt aplikues për vetëdeklarimin e ndonjë objekti informal në funksion të përfshirjes në procesin e legalizimeve. Nga harta e vënë në dispozicion, dallohet qartë që nuk rezultojnë ndërtime në këtë pasuri.

8.11 Referuar VKM-së nr. ***, datë 13.2.2008, “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, të Elbasanit, të Tiranës, të Vlorës, të Durrësit dhe të Shkodrës”, vlera për tokë bujqësore në zonën Kamëz është 626 lekë/m², ndërkohë që sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, vlera është 282 lekë/m².

8.12 Nga hetimi administrativ kryesisht bazuar në faktet e sipërpërmendura, duket se çmimi i blerjes së kësaj toke arë për vlerën 103,776 lekë është me i ulët se çmimi i parashikuar në VKM-në nr. *** datë 13.2.2008 dhe/ose çmimi për m² i tregut në zonën e Kamzës për vitin 2010. Për sa rezultoi subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime.

8.13 Në shpjegimet e saj subjekti i rivlerësimit deklaroi se kjo pasuri gjendet e pozicionuar në fshatin Bathore, përkatësisht në rrugën “***”. Pasuria, ndonëse ndodhet në territorin e bashkisë Kamëz, pozicioni i saj konkret është në zonën e Bathores. Referuar VKM-së nr. ***, datë 13.2.2008, “Për miratimin e çmimeve të trojeve, të përcaktuara në hartat përkatëse për qarqet e Fierit, të Elbasanit, të Tiranës, të Vlorës, të Durrësit dhe të Shkodrës”, vlera për tokë bujqësore në Bathore është 282 lekë/m². Në VKM-në nr. ***, datë 26.11.2008, “Për miratimin e çmimeve të trojeve, që ndodhen në të gjitha bashkitë dhe në disa komuna” janë miratuar çmimet e trojeve urbane brenda vijës së verdhë të të gjitha qyteteve në të 12 qarqet, sipas

³⁰ Shkresa nr. ***, datë 27.5.2019; kartela e pasurisë nr. ***, z.k. ***, lëshuar në datë 25.5.2017; kërkesë datë 1.6.2011; pasqyrë llogaritëse e tatimit për kalimin e të drejtës së pronësisë, datë 27.12.2010; kontratë shitblerje toke bujqësore nr. ***, datë 27.12.2010, me blerës G.K., për tokë arë me sip. 368 m², me çmim 282 lekë/m², në total 103.776 lekë; certifikatë pronësie nr. ***, datë 20.7.2010 për arën me sip. 368 m², në pronësi të z. H.H., kartelë pasurie, hartë treguese vërtetim nr. ***, datë 3.12.2010 nga Bashkia Kamëz; prokura të posaçme; pagesa në “Credins Bank”, datë 6.1.2011.

³¹ Shkresa nr. *** prot., datë 13.5.2019, lënda “Kërkesë për informacion shoqëruar me dokumentacion”, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për të konfirmuar çmimin referues të përdorur për llogaritjen e taksës së kalimit të pronësisë.

tabelave përkatëse. Në kolonën “Përshkrimi i zonave” për qarkun Tiranë – Bashkia Kamëz, është bërë shënimi “Kufizohet me fshatrat Valias, Laknas, Bathore dhe Fratikuturë”.

Subjekti deklaroi se në vitin 2008, kur është miratuar VKM-ja nr. ***, zona e Bathores konsiderohej si “fshati Bathore”, i cili rezultonte jashtë vijës së verdhë të Bashkisë Kamëz. Për të përcaktuar çmimin e tregut të kësaj toke bujqësore, në momentin e lidhjes së kontratës në vitin 2010, referenca ka qenë çmimi i përcaktuar në VKM-në nr. ***, ku për Bashkinë Kamëz, fshati Bathore, rezulton të jetë 282 lekë/m² dhe jo çmimi i parashikuar për qytetin Kamëz, i cili rezulton të jetë 626 lekë/m².

Për të vërtetuar pozicionin e pasurisë, subjekti paraqiti vërtetimi nr. *** prot., datë 3.12.2010, lëshuar nga Bashkia Kamëz, ku ndër të tjera pasqyrohet: “...parcela nr. *** në fshatin Bathore, të kësaj bashkie...”. Ky vërtetim është pjesë e praktikës së kontratës së shitblerjes, e depozituar në deklaratën e pasurisë. Bashkia Kamëz, me shkresën nr. *** prot., datë 13.6.2009, vërteton se sipas dokumentacionit që disponon Drejtoria e Kadastrës, kjo pasuri ndodhet në z.k. ***, Bathore, të Bashkisë Kamëz.

8.14 Analiza ligjore e Komisionit

Sipas dokumentacionit të administruar, kjo pasuri ndodhet në z.k. *** – Bathore, të Bashkisë Kamëz. Në këto kushte, referenca e çmimit të përcaktuar në VKM-në nr. ***, rezulton të jetë 282 lekë /m².

8.15 Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, Komisioni kreu analizën financiare për mundësitë e shtetasit G.K. për të blerë pasurinë tokë arë:

Periudha 1.1.2008 - 31.7.2010	Vlera
Të ardhura nga paga, G.K.,	1,420,028
Detyrim <i>overdraft</i> “Raiffeisen Bank” ³²	99,049
Shpenzime jetike sipas anketës së buxhetit të familjes INSTAT ³³	- 948,775
Shpenzime qiraje ³⁴	- 38,750
Blerë tokë arë	- 103,776
Diferenca e mbetur	427,776

8.16 Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit çmon se duken bindëse dhe të bazuara në prova shpjegimet e subjektit lidhur me këtë pasuri, si edhe nuk ka dyshime lidhur me çmimin dhe burimin që ka shërbyer për blerjen e saj.

9. Kontrolli i deklarimeve vjetore të interesave privatë në ILDKPKI

9.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjen e llogarisë së pagës në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, gjendje në vlerën 60,490 lekë.

9.2 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjen e llogarisë së pagës në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, gjendje në vlerën 589 lekë.

³² Detyrim, datë 31.7.2010.

³³ Shpenzime jetike për një person, Qarku Korçë.

³⁴ Sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin nr. 4.

9.3 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk ka deklaruar çmimin e blerjes së tokës arë, me sip. 368 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në z.k. ***, Tiranë, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014.

9.4 Subjektit iu kërkua të japë shpjegime për sa rezultoi gjatë hetimit, e cila deklaroi se mospasqyrimi në deklaratë i kursimeve nuk ka pasur për qëllim mosdeklarimin e tyre (kursimet nuk kanë qenë në *cash*, por në sistemin bankar). Lidhur me mospasqyrimin e çmimit të blerjes së tokës me sip. 368 m², në pronësi të bashkëshortit të saj, ka qenë një neglizhencë, duke menduar se bëhej fjalë për pasuri të krijuar para martesë, e cila disponohej veçmas nga bashkëshorti dhe subjekti i deklarimit nuk kishte kontribuar në krijimin e pasurisë, në ndryshime, pakësime apo shtesa të vlerës së saj.

9.5 Në përfundim, Komisioni çmon se mospasqyrimi i këtyre të ardhurave nga subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti, në deklaratat periodike vjetore sipas konstatimeve më sipër, për sa kohë që provohet burimi i ligjshëm i tyre, e përjashtojnë rrezikun e gjendjes në situatën e parashikuar nga gerrat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

10. Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në përfundimin se:

- i. Subjekti ka kryer deklarim të saktë dhe në përputhje me ligjin të pasurive dhe interesave private në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm dhe të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së tij.
- iii. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj.

VI. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 8.1.2019, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi.

Pavarësisht nga raporti i dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo indice që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë veprë penale apo cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë

në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për figurën në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

VII. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR AFTËSITË PROFESIONALE

Subjekti i rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ku dhe vijon të ushtrojë detyrën.

Gjithashtu, subjekti ka kryer detyrën si e komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, për periudhat kohore prill 2010 – shtator 2011 dhe nëntor 2012 – prill 2013.

Me mbarimin e periudhës së komandimit të dytë, subjekti ka kryer detyrën e drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër deri në mars të vitit 2016.

ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short dhe të dhënat nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme; si dhe nga analiza e tre denoncimeve të paraqitura nga publiku.

Prokuroria e Përgjithshme, si organi ndihmës për vlerësimin profesional që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit:

- a. Aftësitë profesionale;
- b. Aftësitë organizative;
- c. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Konstatohet se për periudhën tetor 2006 – nëntor 2008, subjekti i rivlerësimi ka ndjekur dhe ka kryer programin e formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili prokuror. Me dekret të Presidentit të Republikës është emëruar *prokurore në stazh* në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, detyrë të cilën e ka ushtruar deri në muajin tetor 2009, kur ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës. Me dekret të Presidentit të Republikës së Shqipërisë është emëruar prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, ku dhe vijon të ushtrojë detyrën.

Gjithashtu, subjekti ka kryer detyrën si e komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për periudhat kohore: *prill 2010 – shtator 2011* dhe *nëntor 2012 – prill 2013*. Me mbarimin e periudhës së komandimit të dytë, ka kryer detyrën e drejtueses së Prokurorisë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), ka ndjekur 244 (*dyqind e dyzet e katër*) procedime dhe 100 (*njëqind*) kallëzime, të caktuara në periudhën tetor 2013 – tetor 2016. Ka përfunduar 208 (*dyqind e tetë*) procedime dhe ka mbartur 6 (*gjashtë*) procedime në vitin 2016.

Pas analizimit të dokumentacionit të sipërpërmendur, Komisioni vlerëson se:

1. Aftësitë profesionale

Në lidhje me çështjet e shortuara, Komisioni vëren se në njëren prej këtyre dosjeve janë konstatuar disa problematika.

Për sa i përket dosjes penale “*Vendim për pushimin e procedimit penal*”, datë 16.6.2016, për procedimin penal nr. ***, për veprën penale “*fshehje e të ardhurave*” dhe “*shkatërrim prone*”, parashikuar nga nenet 150 dhe 180 të Kodit Penal, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër.

Komisioni konstatoi se:

i. Subjekti i rivlerësimit shprehet gabimisht për një shkak tjetër ligjor ku bazohet vendimi për pushimin e procedimit penal, shkak që korrespondon me germën “ë”, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale. Shkakun i shprehur nuk ka lidhje me çështjen - objekt hetimi, në të cilin nuk ka persona nën hetim/të pandehur. Gjithashtu në këtë dokument përmendet emri *D. D.*, person i cili nuk ka lidhje me çështjen.

ii. Nuk është bërë hetim lidhur me lejen datë 4.3.2013 e Qendrës Kombëtare të Licencimit, Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës për subjektin “***” me veprimtari *Leje minerare shfrytëzimi për mineralin krom* etj. Pra, të provohej nga ministria përkatëse fakti që kjo leje nuk ka qenë e revokuar gjatë asaj periudhe. Nuk janë bërë hetime lidhur me shtetasin B.C., i cili nuk figuron të jetë i regjistruar për ushtrim aktiviteti privat, por nuk shpjegohet në cilën cilësi e ka nënshkruar kontratën e nënmarrjes me shoqërinë “***”.

Në lidhje me sa më lart, gjatë mbrojtjes së saj subjekti deklaroi: “*Nga ana ime, në pjesën arsyetuese të vendimit apo në pjesën e bazës ligjore të cituar, nuk është përdorur si referencë për pushimin e çështjes, germa “ë, e nenit 328, e Kodit të Procedurës Penale, e cila lidhet me vdekjen e të pandehurit apo personit nën hetim, ky procedim penal ka qenë regjistruar pa autor. Nga policia gjyqësore rezulton të jetë administruar si pjesë e fashikullit penal edhe një kopje e lejes minerare së shfrytëzimit, dokument i cili është verifikuar nga ana ime në faqen zyrtare të QKB-së në momentin e përfundimit të hetimeve. Nga ana ime nuk është proceduar me printimin nga faqja ëeb e lejes minerare dhe licencës, por jam mjaftuar me verifikimin nëse këto dokumente ekzistojnë në fakt ose jo. Për të verifikuar statusin e shtetasit B.C., si dhe përgjegjësi eventuale të tij në lidhje me konsumimin ose jo të elementeve të figurës së veprës penale, kam kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Tatimeve. Kodi Civil nuk e kufizon individin që të përfshihet në një marrëdhënie kontraktuale, i cili duhet të përmbush detyrimet që rrjedhin nga kontrata. Palët e përfshira në kontratë nuk kanë proceduar me transferimin e lejes minerare nga njëri subjekt në tjetrin, veprim i cili është i pavlefshëm nëse nuk miratohet paraprakisht në ministri.*

Gjithashtu kërkoj të sqaroj se kjo është një ndër 69 dosjet të cilat më kaluan për veprim në datën 21.3.2016, pas zëvendësimit të prokurorit të çështjes H.V. Pavarësisht numrit të lartë të çështjeve dhe marrjes së menjëhershme në dorëzim (pasur në konsideratë edhe faktin që në muajin prill të të njëjtit vit, unë kam pasur edhe dy fatkeqësi në familje, humbjen e babait tim dhe të bashkëshortit), nga ana ime janë marrë masa që secili material të trajtohet me përparësinë e duhur. Por sigurisht ngarkesa mund të ketë ndikuar në ndonjë rast edhe në

cilësinë e arsytimit, apo bërjen e gabimeve materiale gjatë arsytimit (siç është emri D.D., i cili nuk ka lidhje me materialin).

Në përfundim të hetimit, çështja është pushuar në bazë të germës “b”, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti objekt hetimi nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.”

Bashkëlidhur subjekti ka dorëzuar³⁵.

Komisioni çmon se konstatohen mangësi profesionale në moskryerjen e hetimeve të thelluara dhe shteruese si dhe në cilësimin korrekt të bazës ligjore në vendimin e pushimit. Kjo çështje duhet të transferohet në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektim për të verifikuar nëse evidentohen shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ose nëse ka shkaqe për t’u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të subjektit të rivlerësimit.

Më tej, Komisioni vlerësoi se në dokumentet ligjore të paraqitura prej subjektit dhe në katër dosjet e tjera të vëzhguara, subjekti shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Shfaq aftësi për të hetuar, për të marrë urdhra dhe vendime në ndjekje të procedimeve penale konkrete, në respektim të parashikimeve ligjore. Në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale. I kushton rëndësi analizës së provave të administruara dhe interpretimit të ligjit. Ka respektuar parashikimet ligjore dhe ato nënligjore. Subjekti i rivlerësimit zotëron njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor, referuar nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim, Komisioni vlerësoi se çështja e përmendur më lart nuk është e mjaftueshme për ta kualifikuar subjektin e rivlerësimit si “me mangësi” apo “i papërshtatshëm” në drejtim të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, në kuptim të pikave “b” dhe “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose të viktimave, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme. Gjithashtu, çështja e përmendur nuk përbën shkak që mund ta çonte trupin gjykues në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të dhënia e drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

2. Aftësitë organizative

Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka trajtuar gjithsej 210 (dyqind e dhjetë) çështje.

³⁵ Lista e licencave të lëshuar nga QKB-ja, leje, faturë për arkëtim të garancisë financiare për rehabilitimin e mjedisit për vitin 2013, derdhje për thesarin, për subjektin “***” sh.p.k.; shkresa nr. *** prot., datë 28.2.2013; shkresa nr. *** prot., datë 28.2.2013; lejes minerare nr. ***; shkresa nr. *** prot., datë 7.10.2013; vendim nr. ***, datë 26.11.2012; aktverifikimi, datë 17.9.2012; harta topografike zona “***”; oponencë; shkresa nr. *** prot., datë 28.2.2013; ekstrakti historik tregtar “***” sh.p.k.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, analiza e të dhënave të saj bëhet në referencë të ligjit procedural penal, Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe rezulton se ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet.

Konstatohet se subjekti i rivlerësimi, për periudhën e rivlerësimit ka kryerat detyrat specifike që parashikon ligji organik për funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë.

Subjekti ka ushtruar kompetencat që ligji i njej prokurorit, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, kontrollit dhe mbikëqyrjes së policisë gjyqësore. Ka kryer detyrat në pajtim me pikën 2 dhe 2.1 të urdhrit nr. ***, datë 9.5.2008, “*Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë*” e Prokurorit të Përgjithshëm, që përcakton se vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me drejtuesin e prokurorisë, kërkesat për caktimin e masave të sigurimit, vendimin për zgjatjen e afatit të hetimeve dhe konkluzionet përfundimtare për deklarimin e fajësisë dhe caktimin e llojit e masës së dënimit, në rrethanat kur drejtuesi i prokurorisë si organ i centralizuar kontrollon dhe vlerëson ligjshmërinë e veprimeve hetimore dhe të vendimit përfundimtar të prokurorit të çështjes.

Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka aftësi organizative, në mbështetje të pikave 4 dhe 5, nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve, është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Konstatohet se nuk ka të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar dhe nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave, nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i saj nga hetimi i çështjeve apo nga përfaqësimi në gjykim i tyre.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit respekton etikën në punë, integritetin dhe paanësinë, në mbështetje të nenit 75, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Subjekti i rivlerësimit tregon aftësi për të bashkëvepruar në mënyrë të përgjegjshme dhe korrekte me kolegët të nivelit më të ulët hierarkik, në menaxhimin e njëkohshëm dhe me efikasitet të masave dhe veprimeve procedurale hetimore me prioritet e të natyrës urgjente.

Subjekti i rivlerësimit, rezulton se është aktivizuar me pjesëmarrje në trajnime për aktualizimin dhe përsosjen e dijeve.

Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka pasur gatishmëri për t’u angazhuar dhe i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, sipas pikave 4

dhe 5, të nenit 76, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konkluzionet për vlerësimin e aftësive profesionale

Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në një analizë të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016, “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, por çështja nr. *** do të transferohet, në bazë të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljes disiplinore.

VI. DENONCIMET NGA PUBLIKU

Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi (Cami), janë administruar tri denoncime nga publiku.

1. Denoncimi nr. *** prot., datë 3.9.2018, i shtetasit P. D., i cili denoncon subjektin e rivlerësimit se ka pezulluar hetimet me arsyetimin se autori nuk njihet, si dhe është kryer hetim i ngadaltë.
2. Denoncimi nr. *** prot., datë 3.9.2018, i shtetasit M. B., i cili denoncon subjektin e rivlerësimit se ka paraqitur akuzë të pavërtetë, të pambështetur në prova dhe në fakte, duke kërkuar dënim me 5 vjet heqje lirie.
3. Denoncimi nr. *** prot., datë 16.5.2019, i shtetasit N. D., i cili akuzon drejtuesit e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër për veprimtari korruptive, duke pretenduar se prokurorët vijnë dhe ikin sipas qejfit, si dhe nuk respektojnë asnjë orar.

Pasi mori në shqyrtim ankesat e depozituara nga publiku, lidhur me denoncimet e administruara, si dhe të gjithë aktet e tjera ligjore, nga Komisioni konstatohet se nuk ka indice dhe prova të provohen faktet e pretenduara.

Për sa më sipër, Komisioni pasi kreu hetim të hollësishëm mbi këto denoncime dhe pasi u shqyrtuan, në mbështetje të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arriti në përfundimin se nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit.

VIII. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, Esmeralda Keshi (Cami), ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. Ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.
- b. Ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

Pavarësisht, se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar kushtet në lidhje me tri kriteret e rivlerësimit për t’u konfirmuar në detyrë, Komisioni çmon se njëra nga çështjet e përzgjedhura me short,

më konkretisht çështjen penale ku është vendosur “*Vendim për pushimin e procedimit penal*”, datë 16.6.2016, për procedimin penal nr. ***, për veprën penale “*fshehje e të ardhurave*” dhe “*shkatërrim prone*”, parashikuar nga nenet 150 e 180 të Kodit Penal, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, t’i transferohet organit kompetent për inspektim, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 59, e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, dhe referuar gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikave 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Esmeralda Keshi, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Dibër.
 2. Në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë çështjen nr. ***, pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.
 3. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 4. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 19.6.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Pamela QIRKO

Kryesuese

Firdes SHULI

Anëtare

Etlëda ÇIFTJA

Relatore

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj

